

Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu ka kritikuar ashpër vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (ICC) mbi hapjen e hetimeve paraprake të krimeve izraelite të luftës dhe tha se asnjë vendim gjykate nuk do të pengojë Izraelin të ndërmarrë të gjitha masat e sigurisë së saj, raporton Anadolu Agency (AA).

Kryeministri izraelit Netanjahu në paraqitjen e sotme në takimin e Këshillit të Ministrave, tha se Izraeli me kapacitet të plotë do të qëndroj kundër hetimeve të paralajmëruara nga ICC dhe në këtë drejtim do të angazhoj edhe të tjerët. "Ne do të mbrojmë të drejtën e Izraelit për vetëmbrojtje dhe ne nuk do të lejojmë ushtarët izraelitë të ndiqen nga gjykata ndërkombëtare," tha Netanyahu.

Kreu i qeverisë izraelite Netanyahu, vendimin e ICC-së për hapjen e hetimeve mbi krimet e luftës izraelite i ka vlerësuar "hipokrite" dhe shtoi se me këtë mënyrë do të mbrohen terroristët. Prokurorja e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Fatou Bensouda të premtën, tha se janë hapur hetimet paraprake mbi gjendjen në Palestinë. Hetimet u hapën në bazë të nënshkrimit palestinez të statutit të Romës ICC në fillim të këtij viti dhe kërkesën e saj për të hetuar rastet e krimeve të luftës që Izraeli ka bërë që nga mesi i vitit të kaluar.

Presidenti palestinez Mahmoud Abbas deri tani ka nënshkruar gjithsej 20 traktate ndërkombëtare, duke përfshirë statutin e Romës dhe për këtë njoftoi Kombet e Bashkuara. Pritet që anëtarësimi i Palestinës në ICC të aktivizohet prej 01 prillit të këtij viti.